



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORE  
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 1264 prot.

Vlorë, më 31.01 2023

**PROJEKT - VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_ 2023

**“PËR EMËRTIM RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË VLORE”**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Neni 8 , Neni 9/1 pika 1.1/b, pika 1.7/b, Neni 54, pika II, në shkresën nr.4388, datë 22.04.2022 të Kryesisë së Shoqatës “Detaria Shqiptare” si dhe në Relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë emërtimin e rrugës nga qyteti i Orikumit deri te buza e detit me emrin “Brigada e Nëndetëseve”
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”.

  
**KRYETARI**  
Dritan Leli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE**  
**DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. 1264 prot.

Vlorë, më 31.01 2023

**RELACION**

**MBI PROJEKT VENDIMIN “PËR EMËRTIM RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË VLORE”**

**PARA KËSHILLIT BASHKIAK**

**Të nderuar Këshilltarë!**

Ky projektvendim është hartuar bazuar në kërkesën me nr. 4388 , datë 22.04.2022 të Kryesisë së Shoqatës së “ Detaria Shqiptare” dhe gjen bazë në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 8 pika 2, 9, neni 54 pika ll, neni 55 pika 2 .

Nga Kryesia e Shoqatës “Detaria Shqiptare” është propozuar që Këshilli i Bashkisë Vlorë të emërtojë rrugën nga qyteti i Orikutit deri tek buza e detit me emrin “Brigada e Nëndetëseve “.

Shoqata “Detaria Shqiptare” ka si objektiv ruajtjen dhe promovimin e vlerave dhe traditave më të mira detare si dhe tregon interes të vecantë në vlerësimin e kontributeve të anëtarëve të saj shumë të spikatur gjatë gjithë aktivitetit të tyre në forcat detare ndër vite .

Për këtë arsye kjo shoqatë ka propozuar të emërtohet rruga nga qyteti i Orikutit deri tek buza e detit me emrin “Brigada e Nëndetëseve “.

Ky propozim bazohet në aktivitetin e spikatur të kësaj brigade , si një nga njësitë luftarake më të mira të forcave të armatosura detare shqiptare ,qysh nga krijimi i saj në vitin 1958 deri sa pushoi aktivitetin operacional në vitin 1995.

Detarët dhe oficerët e saj në vitin 1961 u kacafytën me ushtarakët sovjetik për të mos lejuar marrjen me forcë të nëndetëseve , në kohën kur marrëdhëniet ndërshtetërore me Bashkimin Sovjetik u prishën .

Nga sa më lart është në vlerësimin tuaj të miratoni emërtimin e kësaj rruge “ Brigada e Nëndetëseve” si nder dhe vlerësim për ushtarakët dhe civilët që kanë punuar në këtë brigadë duke dhënë një kontribut të spikatur në mbrojtjen e atdheut.

**KRYETARI**

**Dritan Leli**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA VLORË**  
DREJTORIA E URBANISTIKES

Nr. 1264 prot.

Vlorë, më 31.01 2023

Lënda : Relacion Sqarues

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Vlorë.

Të nderuar,

Në lidhje me projekt vendimin “Për Emërtim Rrugë në Territorin e Bashkisë Vlorë”, ju bëjmë me dije se:

Porojektvendimi për emërtimin e rrugës “Brigada e Nëndetëseve”, është hartuar bazuar në kërkesën me Nr. prot. 4388, datë 22.04.2022 të Kryesisë së Shoqatës “Detaria Shqiptare”.


Nisur nga situata aktuale e rrugës lidhëse nga Qyteti i Orikumit deri tek buza e detit, drejtorja e Urbanistikës po ju vendos në dispozicion segmentin rrugor të propozuar për vendosjen e këtij emërtimi.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!

*Konc. Darian Hudhra*

**DREJTOR**  
**Zambak Selmani**





BASHKIA VLORE

DREJTORIA E  
URBANISTIKES

PROJEKT: Emeritim Rruge ne Njesine administrative Orikum

Dr. Zambak Selmani

Darjan Hudhra

VLORE 2023

PLANIMETRI E RRUGES SE NENDETESEVE